

	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opstina Pristina - Municipality of Prishtina	
---	--	---

KËRKESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT

Komuna e Prishtinës, FTON të interesuarit, për shprehje interesi në përfitimin e donacionit për ‘Realizimin e Masave të Efiçencës së Energjisë në Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi’.

Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës, ka caktuar një shumë buxhetore për projekte në fushën e Efiçencës së Energjisë, përkatësisht në përmirësimin e saj në ndërtesa të banimit në bashkëpronësi. Si projekt fillestar (pilot), është planifikuar realizimi i masave të Efiçencës së Energjisë në një ndërtesë të banimit në bashkëpronësi.

Qëllimi i projekti: *Përmirësimi i efiçencës së energjisë në ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.*

Kjo shpallje synon ‘Shoqatat e Pronarëve’ (përfaqësues të ndërtesave të banimit në bashkëpronësi), të interesuar për realizimin e masave të Efiçencës së Energjisë në ndërtesat e tyre, përkatësisht përzgjedhjen e të interesuarit (ndërtesës) që i përmbush kriteret e përcaktuara sipas kësaj shpalljeje, dhe më tutje realizimin e punimeve lidhur me masat e EE.

- **Të drejtë aplikimi kanë vetëm përfaqësuesit e ndërtesave të banimit në bashkëpronësi, të cilët e kanë të krijuar ‘Shoqatën e Pronarëve’, sipas ‘Ligjit 04/L-134 Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi’.**

Kriteret e përzgjedhjes për ndërtesën e banimit në bashkëpronësi janë:

1. Të ketë Leje Ndërtimore (apo të jetë e Legalizuar), dhe të jetë e realizuar sipas Lejes Ndërtimore;
2. Të mos ketë ndërhyrje pa leje në ndërtesë (anekse shtesë, ballkone, mbindërtime etj.);
3. Të mos përmbajë më tepër se shtatëmbëdhjetë (17) njësi banimi;
4. Shoqata e pronarëve (respektivisht banorët e ndërtesës), duhet të jenë të gatshëm të lidhin marrëveshje me “Ndërmarrjet Publike”, për kontraktimin e shërbimeve mirëmbajtëse e të ngjashme, për nevojat e ndërtesës të cilën e përfaqësojnë.

Përparpësitë për përzgjedhje

Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

-‘Shoqatat e Pronarëve’ të cilët posedojnë auditim energjetik të ndërtesave të cilat i përfaqësojnë, apo edhe projektin me masat e parapara të Efiçencës së Energjisë dhe planifikimin financiar;

- Ndërtesat të cilat nuk janë të lidhura në rrejtin e ngrohjes qendrore të qytetit, ‘Termokos’, por për të cilat ekziston mundësia e lidhjes në këtë rrjet;

-Ndërtesat të cilat kanë dëmtime në fasadë, kulm apo pjesë tjera të mbështjellësit të ndërtesës.

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen:

- Certifikata e regjistrimit të ‘Shoqatës së Pronarëve’ (përfshirë edhe listën e Kryesisë së shoqatës së pronarëve);
- Përshkrim teknik i ndërtesës:
 - Mënyrat e ngrohjes që shfrytëzohen në njësitë banesore,
 - Shpenzimet mesatare të energjisë elektrike gjatë sezonës së dimrit (për të gjitha tipet e njësive – të dëshmohet me nga një faturë të KEDS për muajin Dhjetor apo Janar)
- Pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve për ‘shprehjen e interes’ për këtë projekt;
- Auditimi energjetik, projekti me masat e parapara si dhe planifikimi financiar (nëse e posedojnë).

Pas përzgjedhjes së ndërtesës së banimit në bashkëpronësi, Komuna e Prishtinës do të vazhdojë me tenderin për realizimin e masave të parapara për ndërtesë.

Lokacioni për dorëzimin e aplikacionit: Ndërtesa e Komunës së Prishtinës, lagjja “Arbëria 3”, Zyra nr. 16 (kati – Përdhesë)
--

Email: urbanizmpirishtine@rks-gov.net
--

Afati i fundit për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e aplikimit të kësaj shpalljeje.
